



Kur detyrohem të bëjmë gusël?

Është detyrë të bëjmë gusël në këto raste:

1. Kur del sperma vrullshëm, me epsh përmes marrëdhënieve intime, përkëdheljes a përfytyrimit.
 2. Kur ndodh ejakulimi në gjumë, gjegjësisht dalja e spermës nga i fjeturi, pa marrë parasysh a e ka vërejtur ai këtë gjë apo jo.
- Nëse ndokush sheh ndonjë ëndërr, mirëpo kur zgjohet nuk gjen gjurmë të spermës nuk detyrohet të bëjë gusël.

3. Kur bashkohen organet gjenitale. Me këtë nënkuptohet futja e kokës së organit të mashkullit në organin e femrës.
4. Kur ndërpritet gjaku i të përmuajshmeve.
5. Kur ndërpritet gjaku i lehonisë.

Kur është sunet të bëjmë gusël?

Është sunet të bëjmë gusël për gjërat në vijim:

1. Për namaz të xhumasë.
2. Për namaz të bajramit.
3. Për ihram të haxhit a të umres.

Gjërat që i ndalohen atij që është me hadeth[1] të madh (papastërti kuptimore të madhe):

1. Namazi i detyrueshëm a vullnetar, duke përfshirë edhe namazin e xhenazes.
2. Tavafi rreth Qabesë.
3. Prekja e Mus'hafit me dorë, pa ndonjë pengesë.
4. Qëndrimi në xhami. Ndërsa, kalimi nëpër xhami për ndonjë nevojë, si p.sh. për të marrë a për të lënë ndonjë send nuk është i ndaluar.
5. Leximi i Kuranit Fisnik. Nga kjo rregull përjashtohen: gruaja me të përmuajshme dhe lehona, meqë sipas mendimit më të saktë të dijetarëve atyre u lejohet të lexojnë Kuran pa e prekur Mus'hafin.

Normat e guslit

1. Nëse një njeri është me hadeth të madh (papastërti të madhe), por harron dhe i fal në atë gjendje disa namaze, ky njeri detyrohet të bëjë gusël posa t'i kujtohet dhe t'i përsërisë të gjitha ato namaze pa i vonuar dhe sipas renditjes.
2. Ai që gjen gjurmë të spermës në rrobat e tija detyrohet të bëjë gusël dhe t'i përsërisë menjëherë dhe sipas renditjes namazet që i ka falur pas fjetjes së tij të fundit, pa marrë parasysh a i kujtohet se ka ejakuluar a jo.
3. Ai që është me hadeth të madh dhe bën gusël, ai gusël i mjafton edhe për abdes. Por, ai i cili bën gusël që është sunet, siç është gusli për namaz të xhumasë a për ihram, ose bën gusël mubah (të lejuar), ai gusël nuk i mjafton për abdes.
4. Nëse ndokujt i del medhji[2] ai nuk detyrohet të bëjë gusël, por duhet ta lagë kokën e organit gjenital me ujë dhe t'i lagë me ujë edhe rrobat (pjesën që e ka prekur medhji). Mirëpo, sunet është të lahet i tërë organi, duke përfshirë edhe herdhët. Dalja e medhjit e prish abdesin.

Marrë nga libri "Et-tuhfe el-islamijje li talibi'l-hidaje er-rabbaniyje" të autorëve Ibrahim El-Ued'an, Muhammed El-Ued'an dhe Abdurrahman El-Ued'an

Përktheu: Jusuf Kastrati

[1] Hadeth i madh quhet papastërtia kuptimore për të cilën jemi të detyruar të bëjmë gusël, ku hyjnë: xhunubllëku, lehonia dhe të përmuajshmet, kurse hadeth i vogël quhet papastërtia për të cilën jemi të detyruar të marrim abdes. Shënim i përkthyesit.

[\[2\]](#) Medhj quhet lëngu që del pa vrull nga organi gjenital i mashkullit për shkak të epshit. Shënim i përkthyesit.